

Këshilli i Ndarjes së Çmimit Shtetëror „Mito Haxhi Vasilev-Jasmin” shpall:

K O N K U R S

për ndarjen e Çmimit Shtetëror „Mito Haxhi Vasilev-Jasmin” për vitin 2025

Me Çmimin Shtetëror „Mito Haxhi Vasilev-Jasmin” jepet mirënjohja për arritjet në fushën e publicistikës dhe gazetarisë.

Çmimi Shtetëror u ndahet individëve, grupit të krijuesve, ekipeve, institucioneve, shoqërive tregtare dhe shoqatave të qytetarëve.

Çmimi Shtetëror me kushtet e caktuara në konkurs mund t’u ndahet edhe shtetasve të huaj, grupit të krijuesve, ekipeve dhe institucioneve të huaja.

Individi që do ta fitojë këtë Çmim i ndahet: diploma dhe shuma në para.

Çdo anëtar i të grupit të krijuesve ose ekipit që do ta fitojë këtë Çmim u ndahet diploma dhe pjesa e barabartë e shumës në para.

Institucioni, shoqëria tregtare ose shoqata e qytetarëve që do ta fitojë këtë Çmim u ndahet diploma dhe plaketa.

Shuma në para e Çmimit Shtetëror „Mito Haxhi Vasilev-Jasmin” është *pesë (5) rroga mujore mesatare* në Republikën e Maqedonisë së Veriut të paguara në tri muajt e fundit të vitit rrjedhës.

Çmimi Shtetëror „Mito Haxhi Vasilev-Jasmin” ndahet, sipas rregullit, çdo vjet.

Në një vjet mund të ndahen më së shumti deri në *dy (2) çmime*.

Iniciativë për ndarjen e Çmimit Shtetëror „Mito Haxhi Vasilev-Jasmin” mund të parashtrojnë: institucionet, shoqëritë tregtare, shoqatat e qytetarëve dhe qytetarët.

Parashtruesit e iniciativës për ndarjen e Çmimit Shtetëror duhet hollësisht ta arsyetojnë iniciativën. Në tekst duhet të përmbahen edhe: të dhënat e sakta të biografisë, adresa e saktë e vendbanimit (adresa-rruga, numri, vendi, qyteti, shteti), të dhënat për rezultatet e arritura në fushën në të cilën është arritur ajo dhe të dhënat e tjera që konsiderohen se do të kontribuojnë në vlerësim.

Parashtruesi duhet ta theksojë edhe fushën për të cilën aplikon – publicistikë apo gazetari.

Parashtruesi i iniciativës duhet ta theksojë emrin dhe mbiemrin e plotë, titullin, firmën, adresën dhe telefonin.

Teksti i iniciativës (i kompletuar) të dërgohet në 15 ekzemplarë, ndërsa punimet (librat, publikimet, etj.) trajtohen si shtojcë dhe duhet të dërgohen të paktën në një (1) kopje

Adresa në të cilën duhet të dërgohen iniciativat është:

Ministria e Kulturës dhe turizmit e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Këshilli i ndarjes së Çmimit Shtetëror „Mito Haxhi Vasilev-Jasmin”, rr. ”Gjuro Gjakoviq” nr. 61 - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Konkursi zgjat nga 1 deri më 31 tetor 2025 Iniciativat dhe propozimet (punimet, librat, publikimet, etj.) të dërguara pas afatit të caktuar për t’i pranuar, si dhe iniciativat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga ana e Këshillit.

Këshilli i Ndarjes së Çmimit Shtetëror
„Mito Haxhi Vasilev-Jasmin”